




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4731/24 datë:16.02.2024



Npi – 01/83 datë: 26.02.2024

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), si dhe neni 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në mbështetje të nenit 6, 7 dhe nenit 10 pika 2 e Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, Npi – 01/173, të datës 27.5.2009; Të nxitur nga nevoja për ndarjen e çmimeve "Sakrifica e Reçakut 1999" si dhe çmimin "Pena e Artë" për personalitetet që kanë dhënë kontribut domethënës për Komunën e Shtimes, duke respektuar procedurat e akteve ligjore dhe nënligjore, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në Seancën e mbajtur më: 26.02.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E QELËSIT PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONEVE PËR
NDARJEN E ÇMIMEVE "SAKRIFICA E REÇAKUT 1999" DHE "PENA E ARTË"**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në Seancën e -II- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 26.02.2024, unanimisht miratoi, strukturën (Qelësin) e përbërjes të Komisioneve për ndarjen e çmimeve "Sakrifica e Reçakut 1999" si dhe çmimin "Pena e Artë" në Komunën e Shtimes në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Dy (2) anëtarë të Komisionit zgjidhen nga Kuvendi (1-Pozita dhe 1-Opozita),
2. Dy (2) anëtarë të Komisionit të emëruar nga Kryetari i Komunës – Shtime.
3. Një (1) anëtar i Komisionit dërgohet nga Shoqëria Civile (OJQ) Komuna e Shtimes.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/68.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi